



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 52

Prishtinë, më 19.06.2012, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Pjesmarrës nga Ministria e FSK-së: Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati, Sekretari i përgjithëshëm në MFSK-së, Shkelzen Sylja dhe Major, Afrim Veseli.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur, më 12.06.2012;
3. Njoftim rreth zhvillimeve në Forcën e Sigurisë së Kosovës nga ana e komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtura, më 12.06.2012.

Kryetari i Komisionit- A ka vërejtje për procesverbalin e datës 12.06.2012?
Meqenëse nuk ka vërejtje, i konsiderojmë të miratuar procesverbalet e mbledhjes së mbajtur më 12.06.2012.

3. Njoftim rreth zhvillimeve në Forcën e Sigurisë së Kosovës nga ana e komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati;

Kryetari i Komisionit- Falënderoi përfaqësuesit e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe njoftoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ka paraparë që në periudha të caktuara të ftohen përfaqësuesit e institucioneve që monitorohen nga Komisioni, në të njëjtën kohë uroi z. Kadri Kastrati për detyrën e re si Komandant i FSK-së.

Tutje shtoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, vlerëson se FSK-ja është institucioni më kredibil në vend, kjo ka ardhur si rezultat i angazhimit permanent në këtë fushë për idealin për liri dhe ndërtimit të shtetit. Për arritjen e objektivave tuaja do të keni mbështetjen e plotë të Komisionit si për bazën ligjore. Për më tepër ia kaloj fjalën Komandantit të FSK-së, z. Kadri Kastrati për të njoftuar për zhvillimet dhe vizionin FSK-së në të ardhmen.

Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati- Falënderoi për ftesën që i është bërë për të njoftuar për zhvillimet në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Tutje shtoi se Forca e Sigurisë së Kosovës, bazuar në mision kushtetues dhe ligjor, dhe e bazuar në planet e saja zhvillimore, ka nxjerrë objektivat dhe prioritetet e saja, në përmbushjen e misionit të vetë.

FSK-së për vitin 2011 ka pasur objektiv kryesor arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO), konform kriterëve të përcaktuara nga NATO-ja, KFOR-it në bashkëpunim të plotë me MFSK.

Me 22 Nëntor 2011, KOMKFOR-it, dha rekomandimin për Këshillin e NATO-së, se FSK-ja, ka arritur kapacitetet e plota operacionale.

Me përmbylljen e KPO, kemi kaluar në fazë më të avancuar të vlerësimit, të emërtuar Rishikimi i Përbashkët i Progresit (RPP), si fazë kalimtare më e avancuar për të kaluar në vlerësimin e gatishmërisë operacionale.

Synim i imi kryesor për vitin 2012 është zhvillimi dhe ngritja e një Force profesionale, e ndërveprueshme, e vetë qëndrueshme, e pajisur me sisteme të teknikës dhe pajisjeve bashkëkohore, dhe në mbështetje, në të gjitha llojet e misioneve të saj, nga një logjistikë e integruar.

Një forcë e aftë, për të vepruar edhe në mjedise më komplekse dhe për t'iu përgjigjur sfidave dhe nevojave që dalin pas rishikimit të misionit të FSK-së.

Synim i imi është dhe mbetet edhe më tutje ruajtja dhe fuqizimi i partneritetit me NATO-në dhe bashkëpunimi me ekipet e NATO dhe KFOR në Kosovë dhe ofrimi i kontributit real për krijimin e një mirëbesimi dhe transparencë rajonale.

Gjatë kësaj kohe, kemi pasur vizita të shumta të rëndësishme në MFSK dhe FSK. Jam vizituar dhe kam pasur takime pune me : Shefin e Shtabit të FA. të Shqipërisë, Shefin e Shtabit FA. të Kroacisë, Komiteti i Mbrojtjes së Gjermanisë, 20 Gjeneral nga SHBA-ja.

Me ftesë zyrtare kam vizituar: Garden Nazionale të Ajovës, ku gjatë kësaj vizite kam realizuar takim edhe me Guvernatori e Shtetit të Ajovës. Kam vizituar SH.P të Ushtrisë Turke, ku jam pritur me nderime të larta ushtarake nga Zv. Shefi i Shtabit Gjeneral Hulusi Akar.

Sapo jam kthyer nga vizita zyrtare në FA. të Republikës së Kroacisë, të cilët na kanë ofruar mbështetje të fuqishme.

Objektivat për vitin 2012, janë:

1. Marrja e detyrave shtesë, brenda mandatit aktual, pas deklarimit të KPO;
2. Vazhdimi i ndërtimit të vlerave dhe identitetit të FSK-së;
3. Integrimet Rajonale dhe vazhdimi i aktiviteteve për anëtarësim në PFP dhe në NATO;
4. Gatishmëria, Profesionalizmi dhe përgatitja e vazhdueshme e njësive të FSK-së për operacione brenda vendit dhe pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit;
5. Rishikimi i legjislacionit dhe përgatitja e FSK-së për të ardhmen.

Sa i përket Personelit, në FSK, kemi 2386 personel ushtarak, nga 2500 të parapara me Planin e Ahtisarit. Nga kjo strukturë meshkuj janë 2194 ndërsa femra 192, ndërsa nga radhët e komuniteteve janë 191, sa i përket përqindjes, minoritetet përfshijnë 8.42%, femrat 6.52 % dhe me këtë përqindje jemi para rajonit për përfshirjen e gjinisë femërore në FSK. Pranimi nga radhët e komuniteteve në FSK, i kemi kushtuar rëndësi të veçantë.

Sa i përket Rekrutimit, gjatë këtij viti, kemi rekrutuar 35 pjesëtar në komponentin rezervë.

Sipas planit të rekrutimit për pjesëtar të rezervës aktive, përmes konkursit të hapur, ne do të pranojmë edhe 235 pjesëtare të rinj. Për këto vende, 2135 kandidat kanë aplikuar, nga të cilët kemi përzgjedhë 410 dhe pas testeve në bazë të kriterëve ne do të pranojmë 235, të cilët më pastaj do të përfundojnë trajnimin bazik gjashtë javor në KDS-së.

Ne kemi filluar kampanjën informuese për pranimin e 10 kadetëve të rinj, për studime universitare në KDS-së dhe në AUK, për vitin akademik 2012/2013.

Me ligjin për pensionim të pjesëtarëve të FSK-së, që e kemi në fuqi, do të pensionojmë 53 pjesëtarët, të cilët i kanë plotësuar kriteret për pensionim sipas ligjit.

Sa i përket Operacioneve dhe Trajnimeve, në realizim të Planit Reagimit Kombëtar, MFSK ka zbërthyer udhëzuesin nga i cili udhëzues KFT ka përgatit planin e reagimit sipas dokumenteve, për këtë funksion FSK ka hartuar planin operativ të reagimit dhe ka ushtruar funksion tjera për mbështetje të institucioneve të vendit.

Gjatë dimrit FSK-ja, ka realizuar operacione në shkallë vendi. FSK reagojë, me të gjitha kapacitetet e saja në deblokimin e 43 vendbanimeve. Operacioni i madhe i FSK, në fshatin Restelicë, në nxjerrjen nga rrënojat e shtëpive të dhjetë viktimave, ishte më shumë se human. Arritëm që pas 10 orësh nën rrënoja të një shtëpie, të nxjerrim dhe të shpëtojmë një jetë, jetën e vajzës që kishte humbur prindërit.

Operacionet e FSK në pastrim e fushave të minuara, kanë vazhduar me intensitet edhe gjatë kësaj periudhe raportuese.

Gjatë kësaj kohe, kemi bërë pastrimin e fushave të minuara në pesë lokacione:

1. Harilaq, 2. Belince, 3. Koshare, 4. Ferizaj(brenda kazermës sonë), 5. Ferizaj (jashtë qytetit).

Kemi bërë pastrimin e mbi 37. 728 metra katror. Janë asgjësuar 287 mjete të ndryshme shpërthyes gjatë vitit 2012.

Deri më tani, sipërfaqe të pastruar nga mjetet shpërthyes nga FSK-ja janë 569.019 metër katror

Ekipe të EOD kujdestarojnë 24/7 në javë dhe kanë kryer mbi 162 intervenime.

Operacione të kërkim shpëtimit në lumenjë, male dhe shpella, të realizuar 43 intervenime;

Operacione dhe inspektime të MKAB (Mbrojtja Kimiko-Atomike-Biologjike) 74 .

Sa i përket trajnimeve dhe shkollimeve jashtë vendit e kemi këtë situatë, në SHBA - 15 pjesëtar, Gjermani - 108 pjesëtar; (në bashkëpunim me SHBA, bazat amerikane N/Oficer) Turqi - 4 pjesëtar (3 kadet në Akademin Ushtarake për pilot Helikopteri, 1 në Kolegj të Luftës) Britani e Madhe – 1.

Për dislokim jashtë vendit në trajnim janë: -Pjesëmarrja në trajnimin vjetor të G.N. të Ajova; (7 pjesëtar), pjesëmarrja në kurse specialistike në SHBA(8 pjesëtar, Gjuhë,logjistik,inteligjencë etj), në Gjermani 9 pjesëtar (për policin e forcës etj), trajnimi i 99 N/Oficerëve në Gjermani (në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA), njësia e NJNRK në Danimarkë;(40 pjesëtarë, Menaxhimi i Emergjencave), një tog në Republikën e Turqisë(32 pjesëtar,operacione paqeruajtëse). Gjatë periudhës vijuese, Me dt. 19.06. 2012 do të dërgojmë një grup të kadetëve në kampin veror në R. Maqedonisë; (10 kadetë, 1 oficer dhe 1 N/Oficer).

Një kompani për trajnimin në operacionet e zbarkimit dhe testimin e mjeteve të komunikimit në R. Maqedonisë, në muajin Gusht 2012, dhe dërgimi i pjesëtare tanë në marshin Tradicional në Holandë.

Ndërsa sa i përket trajnimit brenda vendit kemi këtë situatë:

a)Trajnimet individuale. Trajnimi për qitje me armë personale, nr.1 dhe nr.2, trajnim në gjuhët angleze dhe turke, trajnimi me ekipet mobile;

b)Trajnimet specialistike. Trajnimi me pajisjet e komunikimit, MKAB, kërkim shpëtim, deminim, logjistikë mjekësi etj.

c)Trajnimet kolektive. Gjatë muajit Prill kemi realizuar UF “Shqiponja 1”, në të cilin kemi përfshirë 2300 pjesëtare, me mbështetje të mbi 178 automjeteve.

Është realizuar një skenar i madh me katër ngjarje të mëdha, me 50 injektive dhe simulime të afërta me realitetin. Angazhim i personelit dhe pajisjeve 24/6.

Ushtrim ka përfshirë territorin e tri komunave : Pejë, Prizren, Gjilan, dhe Rahovec. Ushtrimet në Vend Komandë të Bat 1, 2 dhe 3-të BRSH-së, ushtrimi Fushor i BRSH-se “Ujku 1” me dt. 26-30 Mars 2012;

Në fushën e komunikimit, jemi duke realizuar një standard të lartë dhe kemi këto projekte:

1. Projekti radio pajisjeve taktike, është nënshkruar kontrata me Kompaninë Harris, për furnizim dhe trajnim për këto pajisje, është pranuar donacioni nga Ambasada Amerikane, 36 radio pajisjet taktike Harris, dhe ka përfunduar trajnimi 16 pjesëtarëve për këto pajisje, është mbajt trajnimi për përdorim, mirëmbajtje dhe instalim të pajisjeve, sipas kontratës të vitit 2011.

2. Projekti i fijos Optike, ka përfunduar faza e parë për ndërlidhjen brenda katër kazermave të FSK-së: Kazermat në Prishtinë, Pomozotin, Prizren dhe Ferizaj, me fije optike sipas kontratës së vitit 2011 për këtë projekt. Gjatë kësaj periudhe është proceduar kërkesa për ndërlidhjen edhe të tri kazermave: në Gjilan, Istog dhe Mitrovicë, ndërsa rrjeti i jashtëm për ndërlidhje të kazermave me fije optike në nivel vendi është duke u kryer në bashkëpunim me PTK-në, ku kanë përfunduar të gjitha punët teknike.

3. Projekti i rrjeteve të TI-së, gjatë kësaj periudhe kohore është punuar në konfigurimin e pajisjeve dhe lëshimin e aplikacioneve të reja në punë të Intranetit brenda në FSK. Po ashtu është proceduar kërkesa për pajisjet tjera të nevojshme për funksionalizimin e plotë të rrjeteve të TI-së(Harduer, Softuer etj.)

Projekti i SMI (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit), janë bërë përgatitjet me kompaninë këshilluese të NATO-s “NC3A” dhe sipas planit të përbashkët të veprimit jemi në fazën e dytë dhe pritet të përcaktohet kompania fituese për implementimin e këtij projekti. Nga muaji dhjetor do të kalojmë në fazën e testimit për tri module (personel, financa dhe menaxhim të aseteve).

5. Rrjetet dhe Pajisjet e Komunikimit dhe TI-së, momentalisht FSK përdor dy rrjete të radio-komunikimit, rrjeti “HARRIS” dhe rrjeti “MOTOROLA”

Posedojmë dy rrjete të TI-së: MFSK ka në përdorim rrjetin qeveritar të internetit dhe rrjetin e intranetit; (rrjeti Qeveritar).FSK ka në përdorim rrjetin vetanak të internetit, mbulueshmëria e territorit me pajisjet e komunikimit të EOD është 70 deri 80%, me rrjetin e radio pajisjeve Motorola 60%, me radio pajisjet Harris vetëm në vend bazimit tona, si mungesë të nyjeve të komunikimit.

FSK posedon vetëm me një nyje të komunikimit në nyjen e Berishës. Planifikojmë të marrim në shfrytëzim edhe 8 nyje tjera: Sfileni-K.Prizren, Budakova-K.Suharek, Maja e Gjellbër-K.Gjilan, Çiçavica-Vushtrri, Cërnusha-Mitrovicë, Butofci-Prishtinë, Zatriq-Rahovec, Goleshi-Prishtinë. Ne kemi bërë kërkesë Këshillit Siguris së Kosovës, që FSK ti epen në shfrytëzim këto lokacione, për vendosjen e nyjeve të Komunikimit.

5. Logjistika, me qëllim të ndërtimit të identitetit tonë dhe vlerave tona, jemi në proces të kontraktimit të uniformës unike të FSK-së. Kjo uniformë do të jetë unike dhe në ditën e forcës me datë 27 Nëntor të 2012, FSK-ja do të rreshtohet me këtë uniforme të re.

Jemi në zhvillim të infrastrukturës së FSK-së, ndërtimi i objekteve: Objektin e ri të MFSK-së, ndërtimit të objektit të Poliklinikës, kuzhina në Pomozotin, Salla e sporteve, Prishtinë, riparim i konstruksionit të rrugëve në kazermë Prishtinë, salla e sporteve në Ferizaj.

Forca e Sigurisë së Kosovës është e pajisur me dy lloje të armëve të gjata dhe një lloj të armëve të brezit, Pushkë HK me 1275 copë; Pushkë Kolt me 550 copë ; Revole Glock me 486 copë.

Automjetet ekzistuese të FSK-së janë ofruar nga donator të ndryshëm, theksoj donacionin nga shteti Gjerman që ka ofruar dyqindtë e katër automjete, gjithashtu edhe në vitin tjetër do të ketë donacion dhe kjo na ka ndihmuar që FSK-ja të jetë operacionale.

Ka filluar procesi i standardizimit në tri fusha prioritare, standardizimi i materialeve, i administratës dhe në fushën operacionale. Në këtë proces janë të përfshir të gjitha departamentet dhe shefat e shtabeve të njërive në MFSK-FSK. Për këtë janë përgatit planet vepruese për 2012, sipas departamenteve dhe shtabeve.

Pritet të miratohet nga Ministri i FSK-së, Stanagu 6001, i cili përcakton nivelin e gjuhës angleze.

Buxheti i aprovuar për FSK për vitin 2012 është 35.801 832 euro. Në pesë mujorin e parë shpenzimet janë 8. 917.96 euro, apo 25%.

Ndërsa sa i përket bashkëpunimit civilo-ushtarak, FSK-ja ka dhënë asistencë mjekësore për komunitetin serb, nga ana e ekspertëve të FSK-së janë mbajtur ligjërata në shkolla për vetëdijesimin e nxënësve rrezikun nga mjetet e pashpërthyer.

Aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar. Forcimi i bashkëpunimit, partneriteti dhe fuqizimit të raporteve me NATO-n, ekipet e NATO-s dhe me KFOR-in, ka qenë dhe mbetet prioritet i rëndësishëm i FSK-së dhe i imi.

Gjatë kësaj periudhe FSK-ja ka arritur marrëveshje të rëndësishme të veçantë për bashkëpunim dhe partneritet me Gardën Kombëtare të Ajoës dhe ka filluar zbatimin praktik të kësaj marrëveshjeje;

Janë nënshkruara 8 memorandume të bashkëpunimit me: Britaninë e Madhe, Lituaninë, Holandën, Turqinë, Shqipërinë, Maqedonia, Mali i Zi dhe Kroacinë. Vazhdon harmonizimi i qëndrimeve lidhur me nënshkrimin e memorandumeve me, Slloveninë, Gjermaninë dhe Lituaninë.

Krahas këtyre, pjesëtarët e FSK-së kanë marrë pjesë në konferenca dhe trajnime të ndryshme. Kemi emëruar atasheun e parë ushtarak në SHBA, planifikojmë edhe në katër shtete në Bruksel, Shqipëri, Berlin dhe Turqi.

Në kuadër të rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, lidhur me rishikimin Funkcional të Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, kemi formuar gjashtë grupe punuese.

Këto grupe punuese janë për; 1. Definimin e kontekstit Strategjik të Sigurisë dhe Mbrotjes; 2. Trajnim dhe Edukim; 3. Mision, Detyra dhe Strukturë; 4. Infrastrukturë dhe Pajisje; 5. Financa; 6. Kornizë Ligjore. Për këtë qëllim bashkëpunojmë edhe me faktorin ndërkombëtar që të draftohet struktura e ardhshme e ushtrisë së Kosovës.

Në mbështetje të kësaj çështjeje një grup ekspertësh nga SHBA-ja çdo gjatë javë viziton FSK-në për të cilët prezantojmë rezultatet e arritura.

Në fushën e aviacionit kemi bërë konceptin bazë i cili është dërguar në Qeverinë e Kosovës, pasi pas rishikimit të strukturës së sigurisë, FSK-ja do të ketë mandat për këtë fushë. Për këtë arsyeje kemi filluar shkollimin e tre pilotëve.

Pasi FSK-ja posedon të gjitha mekanizmat për fushën e sigurisë, duhet të ketë rolin udhëheqës si dhe mbështetjen e agjencive dhe Ministrive të Republikës së Kosovës, prandaj kërkojmë edhe mbështetjen e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, që ti jep prioritet dhe mbështetje politikave për mbështetjen e FSK-së.

Rekomandimet për forcën e ardhshme janë se vendit tonë i duhet krijimi i një force që do të plotësonte nevojat e vendit për mbrojtje. Zhvillimi i një force të pajisur me teknik

dhe armatim bashkëkohor si në mision e saj brenda vendit po ashtu edhe për operacione paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit, si eksportues i sigurisë, e jo se deri me tani vetëm si konsumues, i duhet një mbështetje nga të gjithë faktorët relevante në Republikën e Kosovës. Është rekomandim i fuqishëm i imi, që FSK-ja të jetë prioritet i Qeveris sonë në planet afat mesme dhe afat gjata, me qëllim që të mundë ti arrijmë këto synime.

Të planifikohet buxhet shtesë apo edhe në formë kredive afatgjatë në aspektin bilateral në mes qeveris dhe shteteve të ndryshme, pasi që pajisjet moderne kanë kosto të lartë, që FSK nuk mund të përballojmë me buxhetin e tanishëm.

Kryetari i Komisionit- Për raportin ne fjalë ftoj edhe Sekretarin e përgjithshëm në MFSK-së, z. Shkelzen Sylja.

Sekretari i Përgjithshëm në MFSK-së, Shkelzen Sylja- Pjesëmarrja ime në këtë takim është në mbështetje të Komandantit z. Kadri Kastrati, në rast se do të ketë pyetje për administratën, prandaj për këtë çështje jam i gatshëm të përgjigjem.

Rexhep Selimi- Bazuar në Raportin e paraqitur nga Komandanti i FSK-së, në të ka informata të mjaftueshme. Duke qenë se si Komision kemi marrë pjesë në zhvillimet e FSK-së, përgëzojmë arritjet e kapaciteteve operacionale.

Pyetja konsiston në identitetin e ri të FSK-së, uniforma e saj, deri ku ka arritur ky proces i quajtur nacionalizim i uniformës, ndërsa çështja tjetër ka të bëjë me armatimin ku në raport tregohet numri i tyre dhe llojin dhe standardin, ndoshta në raport do të duhej të bëhej një specifikim i tyre.

Pyetja ka të bëjë me atë se, pse këto armë nuk janë tani në dorë të pjesëtarëve të FSK-së por përdorën vetëm për roje dhe stërvitje?

Pyetja tjetër ka të bëjë me rezervën, a është thirrur rezerva me dinamikën e paraparë deri tani?

Bazuar në kufizimet që bënë Pakoja e Ahtisarit, a ka ndonjë sferë që nuk e kufizon ky plan por që nuk është arritur nga vet FSK-ja? A mendoni se standardizimi i automjeteve duhet të bëhet për shkak të problemeve teknike që kanë?

Në mbyllje të kësaj ju përgëzoj për punën e arrirë dhe raportin e paraqitur në Komision.

Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati- Sa i përket uniformës dhe identitetit të ri kombëtar, të gjitha shenjat janë aprovuar ku çdo pjesëtarë i FSK-së tani në uniformë e ka shqiponjën, ndërsa sa i përket uniformës jemi në fazën përfundimtare. Sekretari i Përgjithshëm ka formuar Komisionin për negocimin me kompanitë që do të përzgjidhen për këtë qëllim.

Plani është që me 27 nëntor të 2012 FSK-ja të rreshtohet me uniformë të re, ndërsa sa i përket armatimit, akoma gjendet në depo dhe arsyeja e mos shpërndarjes është se nuk kemi për secilin pjesëtar armë, prandaj presim që në kontingjentin e ardhshëm të gjithë pjesëtarët e FSK-së ti ngarkojmë individualisht me armë dhe kjo pritjet të realizohet

brenda vitit. Sa i përket rezervës, ajo është ftuar, vlen të përmendët ushtrimi fushor të cilët kanë marrë pjesë në planifikim dhe ekzekutim të ushtrimit, gjithashtu do të kenë trajnim bazik të ushtarit për pesë jave.

Plani i Ahtisarit nuk e pengon furnizimin me armatim deri në 12.7% por si FSK kemi prioritetet e caktuara si dhe bazuar në limitet buxhetore që janë, por ushtarët janë të pajisur me armë bazë. Bazuar në planin buxhetor për vitin e ardhshëm planifikojmë të blejmë pushkë, gjithashtu nga ana ime është propozuar që për vitin e ardhshëm të blihen armë të llojit snajper dhe mitraloz. Ngecje ka pasur në këtë fushë pasi nga politika është deklaruar se mund të shkaktonte pengesë në aprovimin e kapaciteteve të plota operationale nga Këshilli Veri Atlantik.

Standardizimi është prioritet i imi, pasi kjo do të jetë më efektive që për një kohë të shkurtër të kemi standardin tonë, për këtë qëllim kemi krijuar bordin e ekspertëve për standardizim në të gjitha fushat, përfshirë edhe legjislacionin.

Anton Quni- Vlerësoj të arriturat e FSK-së dhe përgjegjësinë e autoriteteve të FSK-së, që janë në nivel të lartë të paraqitura në raport. Ju përgëzoj për të arriturat dhe punën e bërë.

Fatmir Xhelili- Për rezultatet e arritura nga FSK-ja, si anëtar i Komisionit ju përgëzoj për punën e bërë nga gjithë ekipi juaj. Me qenë se jeni në fazën e hartimit të strategjisë për zhvillimin e FSK-së. Cila do të jetë qasja për zhvillimin e mëtutjeshëm të konceptit të FSK-së?

Komoditeti ofruar nga prezenca e NATO-s në Kosovë për siguri, për të mos shpejtuar zhvillimin e FSK-së.

A keni bërë ndonjë vlerësim bazuar në rreziqet që mund ti kërcënohen Kosovës nga shtetet jo mike, dhe në krahasim me topografinë e Kosovës dhe kapaciteteve njerëzore dhe teknike për mbrojtje.

Nëse do të bëni një vlerësim të tillë, si do ti qaseni zhvillimit të FSK-së, do të përcaktoni koston për zhvillimin e FSK-së për pesë vjetët e ardhshme, duke iu përmbajtur mundësive buxhetore, apo do të përcaktoni objektivat e qartë se çfarë struktura ushtarake i duhet Kosovës dhe realizimin e saj, qoftë edhe me kreditime nga shteti për kompletimin e forcës që të jetë e gatshme të mbroj vendin.

A është bërë evidentimi i pronës, a keni konstatuar se keni nevojë për pronë më të madhe dhe procesi i inventarizimit a po përcillet me kujdes, për tu ditur pronësia e mjeteve kapitale dhe mjeteve materiale?

Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati- Struktura e ardhshme e ushtrisë së Kosovës do të bëhet bazuar në rreziqet dhe kërcënimet. Grupi punues në kuadër të FSK-së është duke bashkëpunuar me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Policinë e Kosovës dhe agjencionet e tjera në kontekstin strategjik, për të vlerësuar rreziqet e mundshme ndaj

Kosovës, nga jashtë dhe brenda. Nga ky studim i grupit punues do të nxirret struktura, misioni dhe detyra.

Nga ana jonë do të propozohet një forcë ushtarake që të jetë e gatshme për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit të shtetit, dhe misioni i dytë do të jetë pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse jashtë Kosovës.

Qasja se si do të jetë në të ardhmen FSK-ja, është se ne duhet ta studiojmë, rreziqet që i kanosen Kosovës dhe struktura e ardhshme e FSK-së, dhe deri në fund të këtij viti do të ketë zhvillime në këtë drejtim. Sa i përket evidentimit të pronës dhe pajisjeve materialo-teknike, çdo vit bëhet evidentimi dhe regjistrimi i tyre. Sistemi i menaxhimit të informacionit, projekt që parashihet të zhvillohet do të na ndihmojë në këtë drejtim, gjithashtu Komisionet e caktuara formohen për vlerësimin e kapitalit dhe vendimet që duhen ndërmarrë për pajisjet ushtarake që nuk përdoren më.

Ganimete Musliu- Përgëzoj arritjet e FSK-së. Nga raporti kuptuam që 128 pjesëtarë të FSK-së janë në trajnime jashtë vendit. Cilat janë kriteret për përzgjedhjen e pjesëtarëve të FSK-së, që dërgohen jashtë vendit, dhe sa është përfshirë gjinia femërore në këto shkollime?

Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati- Kriteret për përzgjedhjen e pjesëtarëve janë të ndryshme, për nivelet e ndryshme të gradave por, për kolegjet e ndryshme, kriteret që merren parasysh janë: Fakulteti i përfunduar, kriteri i gjuhës angleze, që duhet të jetë 70% niveli i njohurisë, e kaluara akademike e suksesshme.

Bordi për trajnime bilaterale shqyrton kërkesat dhe dalin me propozime, propozimi kalon tek Komandanti i FSK-së, i cili miratohet ose jo, por mënyra e përzgjedhjes së tyre kalon në filtra të ndryshëm. Përfshirja e gjinisë femërore është e pranishme, një Toger tani vazhdon shkollimin në Kroaci, përfshirja e femrës është mbështetur nga ana ime qoftë me propozime duke iu dhënë përparësi.

Emin Gerbeshi- Duke qenë se buxheti për FSK-në është i kufizuar, për këtë gjë duhet të bëhet kërkesë e vazhdueshme për rritjen e tij, gjithashtu edhe Komisioni duhet të bëjë presion në rritjen e buxhetit. Ndërsa sa i përket transformimit në ushtri, duket sikur nuk ka pasur kërkesë këmbëngulëse për në transformim të tillë pasi kjo është më se e nevojshme për sigurinë e vendit.

Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati- Për një ushtri moderne kërkohen shpenzime të mëdha, gjithashtu kufizimet që bën NATO-ja, por për të arritur qëllimin duhet që FSK-ja dhe struktura e ardhshme e saj të jetë prioritet i Qeverisë së Kosovës, por dihet kufizimet që bëhen nga pakoja e Ahtisarit.

Rasim Demiri- Vlerësoj arritjet nga ana e FSK-së. Pyetja ime ka të bëjë se si është integrimi i minoritetit boshnjak në kuadër të FSK-së, dhe nëse po, a mbajnë pozita të larta apo të gjithë janë ushtar?

Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati- Përfshirjes së minoriteteve në FSK i kushtohet rëndësi e veçantë. Në kuadër të FSK-së janë 48 pjesëtarë nga komuniteti boshnjak, ata mbajnë grada të ndryshme në kuadër të FSK-së., gjithashtu Akadameia Ushtarake e Maqedonisë ka ofruar mbështetje për shkollimin e disa pjesëtarëve nga komuniteti boshnjak.

Rexhep Selimi- Referuar marrëdhënieve të rëndësishme që janë mes FSK-së dhe shteteve të ndryshme, akademive, ushtrive etj.

Cili është koordinimi mes FSK-së dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës për marrëdhëniet kontraktuale, dhe nëse nuk ka një koordinim cila do të jetë ndihma që mund të ofrohet nga Komisioni?

Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati- Një koordinim i tillë është me Ministrinë e Punëve të Jashtme, si rezultat i kësaj kemi Atashen e parë Ushtarakë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu kemi bërë kërkesë për dërgimin e Atasheve shtesë në qendra të ndryshme evropiane si dhe në Tiranë, pasi kjo do të përshejtonte realizimin e planeve të bashkëpunimit, dhe në këtë drejtim kemi mbështetjen e MPJ-së. Memorandumet e bashkëpunimit bëhen mes Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së shteteve përkatëse, ndërsa për Atashe Ushtarak duhet një bashkëpunim.

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së, Shkelzen Syla- Bazuar në ligjet në fuqi, kur përgatiten marrëveshjet e mirëkuptimit për nënshkrim me Ministrinë e Mbrojtjes së shteteve të caktuara merret pëlqimi nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe në çdo konferencë për sigurinë kemi mbështetjen e tyre.

Kryetari i Komisionit- Nga raporti juaj mund të identifikojmë çështje që të ju përkrahim. Çështje e rëndësishme për MFSK-së dhe Komisionin është çështja e buxhetit, duke qenë se buxheti do të rishikohet, nga ana e FSK-së do duhej të bëhej një vlerësim dhe më pas rekomandimet ti drejtohen Komisionit për mbështetjen e tyre.

Në seminarin e organizuar nga GIZ, si Komision kemi parashtruar kërkesat ndaj Qeverisë Gjermane përmes Ministrisë për ekonomi dhe zhvillim, për ndihmë ndaj FSK-së, për trajnim, edukim, pajisjeve teknike për të përgatitur një ushtri moderne.

Në Komitetin e Sigurisë që udhëhiqet nga Ministri i FSK-së, në të cilin përfshihen agjencionet dhe strukturat e sigurisë, gjithashtu edhe Komisioni përfaqësohet në të, në mënyrë që në përmbyllje të mbikëqyrjes së pavarësisë, procesi i zhvillimeve të FSK-së të përmbyllet me sukses.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, është aktiv në monitorimin e institucioneve të sigurisë, për të parë nga afër zhvillimin e këtyre institucioneve në mënyrë që të ju mbështesim, gjithashtu në mbikëqyrim edhe buxhetin e strukturave të sigurisë kjo në kuadër të funksionit mbikëqyrës të Komisionit, pasi një

shpenzim adekuat i mjeteve do të krijonte besim dhe donacione më institucionet e sigurosh.

Në mbyllje të kësaj pike të rendit të ditës, vlerësoj punën e arritur nga FSK-ja, për këtë qëllim keni mbështetjen e Komisionit me qëllim për të pasur një ushtri të fortë.

Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati- Falënderoj Komisionin tuaj, për mbështetjen që i ka bërë FSK-së, në fushën e legjislacionit dhe profesionalizimin e forcës pasi krijimi i një ushtrie të fortë është projekt kombëtar.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Ju njoftoj se kemi pranuar dy raporte, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës dhe nga Kryeshefi i Inspektoratit policor të Kosovës. Drejtori i Policisë në raport thekson se çështja e rastit të vjedhjes së arit në Dhomën e Dëshmisë i takon Inspektoratit Policor të Kosovës. Këto Raporte do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Gjithashtu kemi një kërkesë të Agjencisë Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilët kanë kërkuar një rritje të buxhetit për shkak të pamundësisë së operimit. Nga ta janë ofruar disa propozime për të kaluar në objekt qeveritar për të mos paguar qira në objektin aktual. Këtë çështje mund ta procedojmë në Parlament.

Nga takimi që kemi pasur në Ministrinë e Punëve të Brendshme, mbi çështjen e kolizionit të ligjeve, siç është rasti me Ligjin për gjuetinë dhe Ligjin për armët. Për këtë qëllim duhet të bëhet një takim me përfaqësuesit profesional të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të bërë harmonizimin e ligjeve.

Gjithashtu duhet rishikuar të gjitha projektligjet që kanë të bëjnë me Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Agjencitë e sigurisë, në rastin e aprovimit të ligjeve për përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, në mënyrë që për ato çështje që janë paraparë kufizime nga pakoja e Ahtisarit të tejkalohen.

Ganimete Musliu- Dua të ngre një shqetësim që gjatë udhëtimit për në Lituanë të një grupi të deputetëve, pjesë e të cilit kam qenë, në Fushë Kosovë jemi ndalur nga një patroll e Policisë së Kosovës të cilët kanë pasur një qasje jo të mirë ndaj deputetëve, ndërsa shoferit i janë marrë dokumentet dhe i janë dërguar në Gjykatë. Për këtë arsye kërkoj nga Komisioni që të bëjë vërejtje për këtë çështje, ose ti drejtohem si grup i deputetëve të rinj Drejtorit të Policisë dhe Inspektoratit Policor.

Kryetari i Komisionit- Për këtë rast mund të bëni një shkresë në emër të deputetëve të rinj dhe t'ia drejtoni Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorit të Policisë, deklarin në Parlament për këtë çështje.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi